

R E L A C I O N

PËR PROJEKTVENDIMIN

"PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN, DHËNIEN, NDRYSHIMIN DHE TRANSFERIMIN E KONTRATAVE TË KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT"

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është miratimi i rregullave të hollësishme për vlerësimin, dhënie, ndryshimin dhe transferimin e kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat, në zbatim të drejtpërdrejtë të delegimeve ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 8, 20 pika 4, 26 pika 2, 30 pika 5, 31 pika 5, 35 pika 2, 42 pika 4, 58 pika 9 dhe 68 pika 1 të ligjit nr. 88/2025 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

Ky projektvendim synon:

- vendosjen e një kuadri procedural të plotë dhe të unifikuar për identifikimin, vlerësimin e fizibilitetit dhe dhënie e kontratave të koncesionit/PPP nga autoritetet kontraktuese në nivel qendror dhe vendor;
- rregullimin e procedurave dhe kriterëve për miratimin paraprak dhe final nga ministria përgjegjëse për financat të projekteve dhe kontratave të koncesionit/PPP, duke garantuar qëndrueshmërinë fiskale dhe kontrollin e detyrimeve kontingjente;
- harmonizimin e procedurave të dhënies me standardet e Direktivës 2014/23/BE, duke përfshirë procedurën me një fazë, me faza dhe me negociim, si dhe rregullat për operatorët ekonomikë dhe grupet e tyre;
- rregullimin e fazës së zbatimit të kontratave nëpërmjet Njësisë së Zbatimit të Kontratës (NjZK), duke parashikuar strukturën, kompetencat, raportimin periodik dhe trajtimin financiar të anëtarëve të saj;
- plotësimin e boshllëqeve rregullatore të identifikuara gjatë zbatimit të ligjit, veçanërisht lidhur me nënkontraktimin, dokumentimin e procedurave, garancitë e ofertës dhe dispozitat kalimtare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është parashikuar si akt nënligjor i detyrueshëm dhe i drejtpërdrejtë në zbatim të ligjit nr. 88/2025 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat". Ligji delegon shprehimisht te Këshilli i Ministrave miratimin e rregullave të hollësishme për nëntë fusha specifike të rregullimit procedural, të cilat pa këtë akt nënligjor do të mbetnin pa zbatim efektiv.

Projektvendimi është në përputhje të plotë me Vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit të politikës 'Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027', në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian 'Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor'". Miratimi i këtij akti nënligjor është kusht i nevojshëm për hyrjen në fuqi të plotë operacionale të ligjit nr. 88/2025, i cili vetë përbën një nga reformat kryesore

strukture në fushën e investimeve dhe prokurimit publik të parashikuara në Agjendën Kombëtare të Reformave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Hyrja në fuqi e ligjit Nr. 88/2025 ka sjellë nevojën e menjëhershme për miratimin e akteve nënligjore për zbatim. Pa këto rregulla, autoritetet kontraktuese nuk kanë bazë ligjore të plotë për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të koncesionit/PPP, nuk ekziston metodologjia e standardizuar për hartimin e studimeve të fizibilitetit, dhe nuk janë të qarta procedurat e miratimit fiskal nga ministria përgjegjëse për financat.

Ky projektvendim është i nevojshëm për:

- mbushjen e boshllëkut rregullator kritik: ligji Nr. 88/2025 delegon tek nëntë nene specifike miratimin e rregullave të hollësishme nga Këshilli i Ministrave; ky projektvendim i mbush të gjitha këto vakume me dispozita konkrete;
- standardizimin e procedurave: parashikimi i dokumenteve standarde të tenderit, të hartuara nga Institucioni Përgjegjës për koncesione dhe partneritet publik privat brenda 3 muajve, si dhe udhëzimeve shpjeguese të detyrueshme, do të unifikojë praktikën e autoriteteve kontraktuese në nivel kombëtar;
- forcimin e kontrollit fiskal: rregullat e hollësishme për miratimin paraprak dhe final nga ministria përgjegjëse për financat, me afate të qarta dhe dokumentacion të specifikuar, mbyllin rrezikun e zbatimit të kontratave me implikime fiskale të paevidentuara;
- mbrojtjen e konkurrencës: rregullat e detajuara mbi kriteret e kualifikimit, garancinë e ofertës dhe metodologjinë e proporcionalitetit për kërkesat e qarkullimit, parandalojnë krijimin e pengesave të padrejta ndaj operatorëve ekonomikë;
- transparencën dhe llogaridhënien: kërkesat e dokumentimit të çdo faze të procedurës, raportimi periodik i NjZK-së dhe publikimi i njoftimeve sipas formateve standarde rrisin ndjeshëm transparencën e procesit të dhënies dhe zbatimit të kontratave.
- Efektet e pritshme janë: rritja e investimeve private nëpërmjet procedurave të qarta dhe të parashikueshme; reduktimi i rreziqeve fiskale për shtetin nëpërmjet kontrollit sistematik të detyrimeve kontingjente; dhe harmonizimi i plotë me acquis-in e BE-së në fushën e koncesioneve, si kusht i procesit të integritetit evropian.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në:

- nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- nenet 11 pika 8, 20 pika 4, 26 pika 2, 30 pika 5, 31 pika 5, 35 pika 2, 42 pika 4, 58 pika 9 dhe 68 pika 1 të ligjit nr. 88/2025 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të cilat delegojnë shprehimisht miratimin e këtij akti;
- ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, për sa i përket procedurave të PPP të dhëna sipas Kreut VI të rregullave;
- ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për sa i përket rregullave të miratimit fiskal dhe kërkesave buxhetore;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", i ndryshuar, për sa i përket ndërlidhjes me projektet e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

Projektvendimi është në përputhje me rendin juridik të brendshëm. Dispozitat e tij nuk bien në kundërshtim me Kushtetutën apo legjislacionin material e procedural në fuqi. Rregullat e parashikuara janë proporcionale me objektivat e ndjekur dhe nuk kufizojnë të drejta të operatorëve ekonomikë përtej kufijve të lejuar nga ligji.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektvendimi është përafruar me:

- Direktivën 2014/23/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, "Për dhënien e kontratave koncesionare" — kryesisht nenet 26 (grupimet e operatorëve ekonomikë), 30 (rregullat e procedurave), 37 (garancitë procedurale dhe dokumentimi), 38 (zgjedhja dhe vlerësimi), 39 (afatet kohore) dhe 41 (kriteret e dhënies);
- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për prokurimin publik", neni 19 (grupimet), neni 58 (kriteret e kualifikimit), neni 72 (ndryshimi i kontratave) dhe neni 73 (zgjedhja), të cilat zbatohen si rregulla referente për PPP-të e dhëna sipas Kreut VI;
- rekomandimet e SIGMA për procedurat e koncesioneve dhe PPP, veçanërisht lidhur me proporcionalitetin e kriterëve të kualifikimit, metodologjinë e vlerës për para dhe strukturimin e njësisë të zbatimit të kontratave;
- standardet e Bankës Botërore dhe EBRD-së për studimin e fizibilitetit të projekteve PPP dhe metodologjinë e Krahasuesit Sektorial Publik (PSC) si mjet i vlerësimit të vlerës për para.
- Ligji nr. 88/2025, të cilit i shërben ky projektvendim, është pjesërisht i përafruar me Direktivën 2014/23/BE sipas shënimit të tij. Ky akt nënligjor zbatues thellohet në përafrimin duke transpozuar dispozitat operative të direktivës në nivel procedural, duke plotësuar kështu kushtet e nevojshme për progresin e Shqipërisë në kapitullin e prokurimit publik të procesit të anëtarësimit në BE.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është i strukturuar në tetë krerë, si vijon:

Kreu I — Dispozita të përgjithshme (nenet 1–2): Përcakton qëllimin dhe objektin e rregullave, si dhe pragun monetar minimal të zbatueshëm sipas vendimit nr. 291/2024 të Këshillit të Ministrave.

Kreu II — Rregullat operative (nenet 3–20): Rregullon fazat paraprake të ciklit të projektit, nga identifikimi dhe komisioni i koncesionit/PPP deri tek studimi i fizibilitetit dhe miratimi nga ministria e financave. Parashikohen: (i) raporti paraprak përmbledhës me elementet e detyrueshme duke përfshirë përmbledhjen ekzekutive; (ii) analiza teknike, mjedisore, ekonomike-financiare, ligjore dhe justifikimi i vendimit për formën e zbatimit; (iii) procedura dhe kriteret e vlerësimit nga ministria e financave me afate të qarta 40+15 ditë; (iv) kërkesat buxhetore dhe ndërlidhja me MTBP; dhe (v) trajtimi i veçantë i projekteve të Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, ku studimi i fizibilitetit përgatitet sipas ligjit 88/2025 dhe pastaj projekti kalon për pjekurim sipas VKM 887/2022.

Kreu III — Procedura dhe kriteret e vlerësimit nga MF (nenet 13–20): Rregullon detyrimet e paraqitjes, dokumentacionin e kërkuar, analizën fiskale dhe vendimmarrjen e ministrisë përgjegjëse për financat.

Kreu IV — Rregullat e përgjithshme të procedurave konkurruese (nenet 21–32): Parashikon kompetencat e kreut të autoritetit kontraktues, miratimin dhe përdorimin e dokumenteve standarde të tenderit, hartimin dhe publikimin e dokumentacionit, urdhrin e dhënies, udhëzimet për ofertuesit, kriteret e kualifikimit të përgjithshëm dhe specifik me kufizimin e proporcionalitetit të qarkullimit vjetor, formularin e vetëdeklarimit të përmbledhur, grupimet e operatorëve ekonomikë pa detyrimin e formës juridike në fazën e dorëzimit, garancinë e ofertës me tavan 2% dhe bazë rast-pas-rasti, dhe njoftimin e diskualifikimit.

Kreu V — Procedurat e dhënies me koncesion (nenet 33–38): Parashikon tre lloje procedurave: (i) procedura me një fazë — e thjeshtë dhe e hapur për çdo operator; (ii) procedura me fazë — me fazë kualifikimi dhe fazë ofertash, me opsion negocimi të rregulluar hollësisht me nënpika a–g; dhe (iii) rregullat e garantimit të konkurrencës, njoftimit të anulimit dhe dokumentimit të çdo faze.

Kreu VI — Procedurat e dhënies së PPP (neni 39): Parashikon zbatimin e rregullave të ligjit të prokurimit publik dhe VKM-së përkatëse, për aq sa nuk bien ndesh me ligjin 88/2025 dhe këto rregulla.

Kreu VII — Miratimi, zbatimi dhe menaxhimi i kontratave (nenet 40–42): Rregullon miratimin final të kontratës nga MF me afat 40+15 ditë, procedurën kur kontrata refuzohet, miratimin e ndryshimeve dhe transferimeve, si dhe rregullat e nënkontraktimit me tavan 50% të vlerës, detyrimet e deklarimit dhe monitorimit.

Kreu VIII — Zbatimi dhe menaxhimi i kontratave (nenet 43–44): Rregullon krijimin dhe funksionimin e NjZK-së me strukturë minimale prej 3 anëtarësh me numër tek, detyrimet e konfliktit të interesit dhe konfidencialitetit, raportimin periodik dhe ngritjet emergjente jashtë ciklit normal, trajtimin e kontratave ekzistuese brenda 6 muajve, dhe shpërblimin e veçantë të anëtarëve të NjZK-së sipas numrit të kontratave me tavan 10 kontrata.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare (neni 45): Parashikojnë detyrimin e Institucionit përgjegjës për koncesionet dhe partneritet publik privat për miratimin e dokumenteve standarde brenda 3 muajve dhe hartimin e udhëzimeve shpjeguese të detyrueshme.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi:

- të gjitha institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, si autoritete kontraktuese, për zbatimin e procedurave të parashikuara në këto rregulla;
- Institucioni Përgjegjës për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, për hartimin dhe miratimin e dokumenteve standarde të tenderit brenda 3 muajve, hartimin e udhëzimeve shpjeguese, dhënien e asistencës teknike dhe monitorimin e zbatimit të rregullave;
- Ministria e Financave, për zbatimin e procedurave të miratimit paraprak dhe final të projekteve dhe kontratave, vlerësimin fiskal dhe lëshimin e miratimeve brenda afateve të parashikuara;

- Agjencia e Prokurimit Publik, për publikimin e dokumenteve standarde të tenderit në bashkëpunim me Institucionin Përgjegjës për Koncesionet dhe Partneritetet Publike Private;
- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, për koordinimin e zbatimit të vendimit dhe propozimin e ndryshimeve të nevojshme.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, duke qenë se vendimi propozohet sipas bazës ligjore të tij. Në kuadër të procesit të bashkërendimit institucional, projektvendimi u është përcjellë për mendim institucioneve përkatëse sipas fushës së përgjegjësisë. Gjithashtu për t'u theksuar fakti që gjatë procesit të hartimit janë marrë parasysh komentet dhe rekomandimet teknike të SIGMA-s si partner i Bashkimit Evropian, të cilat kanë kontribuar në harmonizimin e dispozitave procedurale me acquis-in e BE-së dhe standardet ndërkombëtare të prokurimit publik dhe koncesioneve.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk parashikon efekte buxhetore shtesë direkte për buxhetin e shtetit. Shpenzimet operative për zbatimin e procedurave të parashikuara mbulohen brenda buxheteve ekzistuese të autoriteteve kontraktuese, Institucionit Përgjegjës për Koncesionet dhe Partneritet Publik Privat dhe Ministrisë së Financave. Shpërblimet e veçanta të anëtarëve të NjZK-së të parashikuara në nenin 44 do të përfshihen në kërkesat buxhetore vjetore të autoriteteve kontraktuese përkatëse, pa krijuar detyrime shtesë për buxhetin qendror.

Efeki fiskal afatgjatë i këtij projektvendimi pritet të jetë pozitiv: vendosja e mekanizmave rigoroz të miratimit fiskal paraprak dhe final do të reduktojë rrezikun e materializimit të detyrimeve kontingjente të paparashikuara nga kontratat e koncesionit/PPP, duke kontribuar kështu në qëndrueshmërinë e borxhit publik.

MINISTRI
DELINA IBRAHIMAJ

